

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 259/ 21

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 9 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër te protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Joss &Krasniqi-Bazë” SH.P.K. me seli ne Junik , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sanimi - Ndërtimi i rrugëve me asfalt me numër te prokurimit :632-21-396-5-1-1 dhe numër te brendshëm 632-21-001-515, të iniciuar nga AK /KK Gjakovë, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 26 mars 2021 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar**, ankesa e OE “Joss &Krasniqi-Bazë” SH.P.K. me seli në Junik, me nr. të protokollit 259/21, e datës: 23.03.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sanimi - Ndërtimi i rrugëve me asfalt me numër te prokurimit :632-21-396-5-1-1 dhe numër te brendshëm 632-21-001-515, të iniciuar nga AK /KK Gjakovë, i njëjti nuk e ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afatit ligjor sipas nenit 108/A, të LPP, si dhe i njëjti nuk ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit dhe është palë pa interes juridik material konform nenit 4. 26 lidhur me nenin 111 të LPP-së.
- II. **Mbetet në përgjegjësi** të autoritetit kontraktues- KK Gjakovë, që të vazhdoj më tutje me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sanimi - Ndërtimi i rrugëve me asfalt me numër te prokurimit :632-21-396-5-1-1 dhe numër

te brendshëm 632-21-001-515, të iniciuar nga AK /KK Gjakovë, (përkitazi me këtë ankesë nëse nuk ka ankesë tjetër).

- III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që i njëjti nuk e ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afatit ligjor sipas nenit 108/A të LPP-së, dhe se kjo ankesë nuk është e lejuar sipas nenit 4. 26 lidhur me nenin 111 të LPP-se.
- IV. Me qenë se ankesa e OE “Joss &Krasniqi-Bazë” SH.P.K. me seli në Junik hedhet si e pa lejuar , operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.
- V. **Obligohet**, OE ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues KK Gjakovë, ka zhvilluar procedurë të negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë, ku njoftimin për kontratë e ka publikuar me date 23.02.2021, hapjen e ofertave e ka bere me date 05.03.2021 dhe njoftimin për dhinë të kontratës së bashku me letrën standarde e ka publikuar me date 10.03.2021, i pa kënaqur me këtë vendim OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues me datën 18.03.2021.

Operatori ekonomik ankues: “Joss &Krasniqi-Bazë” SH.P.K. me seli në Junik si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 23 mars 2021 me nr. 259/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për procedurën e negociuar pa publikimin e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi - Ndërtimi i rrugëve me asfalt me numër të prokurimit :632-21-396-5-1-1 dhe numër te brendshëm 632-21-001-515, të iniciuar nga AK /KK Gjakovë.

OE ankues pretendon që AK me dhënien e kontratës ka shkelur nenin 1, nenin 2, nenin 6, 27,28, 35,39,104 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE “Joss &Krasniqi-

Bazë” SH.P.K. me seli në Junik me nr. të protokolli. 259/21, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sanimi - Ndërtimi i rrugëve me asfalt me numër te prokurimit :632-21-396-5-1-1 dhe numër te brendshëm 632-21-001-515, të iniciuar nga AK /KK Gjakovë dhe konstaton se e njëjta ankese nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është e lejuar sipas nenit 108/A dhe nenit 4. 26 lidhur me nenin 111 të LPP-se.

Njoftimin për dhënie te kontratës së bashku me Letrën Standarde AK e ka publikuar me datën 10.03.2021, ndërsa kërkesën për rishqyrtim te këtij vendimi, OE ankues e ka parashtruar në Autoritetin Kontraktues me daten 18.03.2021, (pas afatit ligjor prej 5 ditëve siç parashihet me nenin 108/A të LPP-së).

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se për procedurat e udhëhequra dhe ekzaminim vlerësimin dhe krahasimin ofertave si dhe rekomandimin për dhënie të kontratës bartë përgjegjësi vetë AK sepse OSHP nuk është marrur me shqyrtimin e aktivitetit të prokurimit në fjalë për faktin se ankuesi është konsideruar si palë pa interes në këtë aktivitet, ngase i njëjti nuk ka qenë fare pjesëmarrës në këtë aktivitet dhe se kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar pas afatit ligjor sipas nenit 108/A të LPP-së.


Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesë-padi në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së

Z. Ardian Behra



Vendimi i dorëzohet:

1. 1x1 AK- KK Gjakove
2. 1x1 OE “Joss &Krasniqi-Bazë” SH.P.K. me seli në Junik
3. Arkivës së OSHP-së.